



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriaz" nr 29. të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. N.SH. Radio Taxi " O.K " Adresa: Besim Shala p.n. Prizren, R. e Kosovës, me NRB 810587181.

### Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe N.SH. Radio Taxi " O.K " - Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

### Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. N.SH. Radio Taxi " O.K " - Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikën e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi N.SH. Radio Taxi " O.K " - Prizren në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.



3. Kolegji Biznesi do të mbështes, N.SH. Radio Taxi " O.K " - Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomis dhe Jurispodencës-sipas nevojave që paraqet N.SH. Radio Taxi " O.K " - Prizren.

#### Neni 4

##### Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këti memorandumit është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

#### Neni 5

##### Kopjet e Memorandumi

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


#### Neni 6

##### Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

#### PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

  
/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/  
D e k a n



N.SH. Radio Taxi " O.K " - Prizren

  
/Sabir Fireci/  
Drejtore



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 09 / 12 / 2020

